

vetë. Nëse nuk e aprovon këtë gjë, ti nuk mund të detyrohesh të vijosh procedurat më tej. Procesi i përcaktimit të moshës nuk mund të japë moshën e saktë. Nëse autoritetet janë të pasigurta për moshën tënde, ti duhet të trajtohesh njësoj si të ishe fëmijë.

- Fakti që ti je një fëmijë i ndarë nuk është arsye apo shkak për ndalimin tënd. Nëse ti thyen ligjin, ti duhet të trajtohesh njësoj si gjithë fëmijët e tjerë në vendin e ri ku ke mbërritur.
- Gjetja e familjes tënde duhet të ndodhë vetëm nëse ti e pranon këtë dhe nëse nuk krijon pasiguri as për ty e as për familjen tënde. Vetëm specialistë të organizatave për kërkimin e familjeve dhe vendosjen e kontakteve duhet të merren me gjetjen e familjes tënde për ty.
- Vendi ku ti duhet të vendosesh për përkujdesje duhet të caktohet bazuar në situatën tënde individuale dhe në atë që është më e mira për ty. Ty duhet të të krijohet mundësia të jetosh me një familje por, nëse për ty është më mirë, ti mund të jetosh me fëmijë të tjerë në shtëpi ku rrinë grupe fëmijësh që ndihmohen nga punonjësve që përkujdesen për ta. Ti nuk duhet të rrih me të rritur. Ty të takon të vizitohesh tek doktori, të shkosh në spital dhe të ndjekësh shkollën si gjithë fëmijët e tjerë që jetojnë në vendin e ri ku ti ke mbërritur. Fëmijëve më të rritur që duan të punojnë, të ndjekin kurse të ndryshme ose që kanë nevojë për ndihmë sociale duhet t'u krijohen mundësitë dhe të mbështeten në të njëjtën mënyrë si gjithë fëmijët e tjerë.
- Situata jote duhet të shqyrtohet gjithmonë me shumë vëmendje në mënyrë që të mund të merren vendimet më të mira për ty. Mënyra e shqyrtimit të situatës tënde është shumë e rëndësishme për marrjen e vendimit nëse mund të qëndrosh apo jo në vendin e ri ku ke mbërritur. Nëse mbush 18 vjeç gjatë kohës në të cilën është duke u marrë vendimi për qëndrimin tënd, ky vendim duhet të vijojë të merret sikur ti të ishe ende fëmijë.
- Ty duhet të të vihet në dispozicion një avokat pa pagesë që të ndihmojë me gjithçka që ka të bëjë me kërkesën tënde për të qëndruar në vendin e ri ku ke mbërritur.
- Vendimet mbi kërkesën tënde duhet të merren vetëm

nga persona që e njohin procesin e kërkimit të azilit, emigracionin dhe të drejtat e fëmijëve. Ti duhet të ngresh zërin dhe të dëgjohesh nëse mendon se vendimi i marrë është i gabuar. Nëse të duhet të takohesh me autoritetet, ti duhet të shoqërohesh nga një avokat apo dikush tjetër tek i cili ke besim. Ti duhet të lejohesh të tregosh ç'ka ndodhur në mënyrën me të cilën ndihesh më rehat, ndoshta duke shkruar apo pikturuar, nëse kjo të ndihmon.


- Kur autoritetet marrin një vendim mbi kërkesën tënde për qëndrim në vendin e ri ku ke mbërritur, ata duhet të mendojnë për moshën tënde duke pasur parasysh që ti mund ta kesh të vështirë të shprehësh dhe shpjegosh ç'ka ngjarë me ty dhe familjen tënde. Autoritetet e vendit ku ti ke mbërritur duhet të të lejojnë të qëndrosh në këtë vend nëse janë të pasigurt për atë që mund të ngjasë me ty nëse nuk të lejojnë të qëndrosh.
- Qeveria e vendit të ri ku ke mbërritur duhet të bëjë përpjekje për ribashkimin tënd me familjen tënde, nëse kjo është gjëja më e mirë dhe më e sigurt për ty.
- Ti duhet të lejohesh të qëndrosh në vendin e ri ku ke mbërritur nëse kjo është gjëja më e mirë për ty. Kjo sepse mund të jetë e pasigurt që ti të kthehesh në vendin tënd ose sepse nuk ka asnjë person që të kujdeset për ty atje. Ti duhet të ndihmohesh të bësh një jetë të re tënden në vendin e ri ku ke mbërritur.
- Ti duhet të kthehesh në vendin tënd ose të lëvizësh në një vend tjetër vetëm nëse kjo është gjëja më e mirë për ty. Nëse kjo të ndodh, dikush tek i cili ti ke besim duhet të të shoqërojë. Para se të ndodhë kjo, qeveria e vendit të ri ku ke mbërritur duhet të sigurohet që ky veprim të bëhet në mënyrë të tillë që ti të ndiesh siguri dhe mbrojtje. Qeveria e vendit të ri ku ke mbërritur duhet të sigurohet që, kur ti të mbërrish në vendin tënd apo në një vend tjetër, të gjendet dikush që do të kujdeset për ty nëse ti je ende fëmijë.

Programi për Fëmijët e Ndarë në Evropë
www.separated-children-europe-programme.org



Me mbështetje financiare të
 EC Daphne III Program

PRAKTIKA E MIRË PËR FËMIJËT E NDARË



Rrjeti Rinor i Programit për Fëmijët e Ndarë në Evropë-SCEP

&



Separated Children in Europe Programme

Bazuar në Deklaratën e Praktikave të Mira, 2009

Një fëmijë i ndarë është larguar prej vendit të tij dhe nuk është i shoqëruar nga asnjë prej prindërve apo ndonjë i rritur që e njuh dhe që mund të kujdeset për të. Ka disa arsye për të cilat një fëmijë është i detyruar të lërë vendin e tij si p.sh.: ai ka nevojë të kërkojë azil; ka nevojë dhe kërkon mundësi për një jetesë më të mirë; është sjellë në një vend tjetër për t'u shfrytëzuar nga të rritur që duan të përfitojnë prej tij. Të gjithë këta fëmijë kanë nevojë për mbrojtje.

Programi për Fëmijët e Ndarë në Evropë (Separated Children in Europe Programme - SCEP) është një grup organizatash evropiane të cilat luftojnë dhe punojnë për mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave të Fëmijëve të Ndarë në Evropë. Ekziston edhe një grup rinor i SCEP. Broshura që keni në dorë ju tregon se çfarë është kujdesi dhe trajtimi më i mirë për fëmijët e ndarë sipas SCEP, megjithëse ka raste që kjo mund të mos zbatohet në realitet. SCEP dhe Rrjeti rinor i tij sugjerojnë që ju të njiheni më shumë me të drejtat tuaja të cilat janë të përmbledhura në Konventën për të Drejtat e Fëmijës – www.unicef.org.

Për ju mund të jetë e dobishme ta lexoni këtë broshurë së bashku me kujdestarin tuaj ose me një njeri tjetër tek i cili keni besim.

Parimet kryesore që duhen mbajtur mend nga të rriturit që kujdesen për ju apo të rritur të tjerë që ju i takoni gjatë procesit të emigrimit janë:

- Të rriturit duhet të sigurohen që ajo çka bëjnë është më e mira për ju. Çdo fëmijë është i ndryshëm dhe çfarë është më e mirë për një fëmijë mund të mos jetë e tillë për një fëmijë tjetër.
- Ti ke të drejtë të jetosh. Nga cilido vend të kesh ardhur, qeveria e vendit të ri ku ti ke mbërritur duhet të sigurojë që të jesh i mbrojtur dhe që të është siguruar gjithçka për të cilën ke nevojë që të jetosh dhe të zhvillohesh.
- Ti nuk duhet të trajtohesh ndryshe apo padrejtësisht vetëm sepse vjen nga një vend tjetër.
- Ti ke të drejtë të thuash atë që mendon se duhet të

ndodhë me ty. Të rriturit duhet të marrin në konsideratë mendimin tënd kur të marrin vendime. Nëse të nevojitet ndihmë për të shprehur mendimin tënd tek të rriturit, kërkoje atë.

- Ty duhet të të tregojnë të drejtat e tua, përgjegjësitë e tua dhe se çfarë ndodh lidhur me qëndrimin tënd në vendin ku ke mbërritur. Ky informacion duhet të të jepet në një mënyrë dhe gjuhë të kuptueshme për ty.
- Ti duhet të kesh një përkthyes sa herë të të nevojitet. Të rriturit që kujdesen për ty duhet të sigurojnë që përkthyesi flet gjuhën tënde dhe që ti kupton gjithçka thuhet dhe diskutohet.
- Të rriturit duhet të sigurojnë që informacioni për personin tënd të mos diskutohet me të tjerë, përveç rasteve kur kjo shërben që ti apo ndonjë fëmijë tjetër të jeni më të mbrojtur.
- Ti duhet të ndihmohesh të ruash kulturën dhe gjuhën tënde dhe të praktikosh besimin tënd fetar.
- Organizata të ndryshme që janë angazhuar dhe përfshirë në jetën tënde duhet të punojnë së bashku që të mund të marrin vendimet më të mira për ty.
- Të rriturit që punojnë me ty duhet të njohin kulturën tënde dhe të dinë të bisedojnë me ty. Pyetjet që ata të drejtojnë gjatë bisedës duhet të bëhen në mënyrë të tillë që ti të ndihesh mirë dhe jo në siklet.
- Vendimet që të rriturit marrin për ty duhet të parashikohen për një kohë të gjatë në mënyrë që të bëhet e mundur që ti të bësh plane për të ardhmen tënde.
- Vendimet që janë marrë për ty nuk duhet të vonojnë dhe duhen bërë sa më shpejt që të jetë e mundur duke lënë kohën e mjaftueshme për t'u studiuar dhe për t'u marrë në konsideratë me kujdesin e duhur.

Për shkak se ti je një fëmijë i Ndarë:

- Ti ke të drejtë të kërkoesh azil dhe duhet të lejohesh të qëndrosh në vendin e ri ku ke mbërritur për sa kohë kërkesa jote për azil studiohet dhe merret në shqyrtim. Fëmijët dhe të rriturit mund të kenë arsye dhe shkaqe të ndryshme që i detyrojnë të kërkojnë azil.

- Nëse nuk po kërkon azil, ty të lejohet të qëndrosh në vendin e ri ku ke mbërritur derisa të merret një vendim lidhur me atë çka është më e mira për ty.
- Qeveritë duhet të kujdesen për mbrojtjen tënde nëse ti je sjellë në vendin e ri ku ke mbërritur nga njerëz që të kanë detyruar të bësh gjëra që janë të këqija për ty apo janë në kundërshtim me ligjin. Nëse kjo të ka ndodhur ty, ti nuk duhet të trajtohesh sikur të ishe kriminel. Askush nuk duhet të të detyrojë të ndihmohesh në gjetjen e personave që të kanë sjellë me forcë në këtë vend. Edhe nëse ti nuk dëshiron ta bësh një gjë të tillë, duhet të marrësh ndihmën e nevojshme për të qëndruar në këtë vend. Ti duhet të lejohesh të qëndrosh në vendin e ri ku ke mbërritur deri sa të merret vendimi më i mirë për ty.

Si duhet të trajtohesh dhe të marrësh kujdesin e duhur

- Kur ti mbërrin në kufirin e vendit të ri, duhet të lejohesh të hysh në këtë vend
- Autoritetet e kufirit duhet të sigurohen që ti je një fëmijë i Ndarë që ti më pas të mund të marrësh mbrojtjen dhe kujdesin më të mirë.
- Ty duhet të të caktohet një person kujdestar apo këshillues që do të marrë pjesë në gjithë vendimet që merren për ty. Kujdestari do të të ndihmojë që të të dëgjohet mendimi dhe të sigurojë që ti t'i marrësh të gjitha shërbimet e duhura. Kujdestari duhet të kujdeset për kontaktin tënd me autoritetet dhe sidomos duhet të sigurojë që çdo vendim i marrë është në interesin tënd më të mirë.
- Autoritetet në vendin e ri ku ke mbërritur duhet të informohen për mbërritjen tënde. Ato duhet të marrin gjithashtu informacion mbi personin tënd për të siguruar kështu kujdes dhe mbrojtje për ty. Autoriteteve do t'u duhet të flasin me ty rreth situatës tënde. Kur të flasësh me autoritetet duhet të jesh me dikë tek i cili ke besim dhe duhet të ndihesh mirë dhe jo në siklet.
- Nëse moshë që ti tregon për veten tënde nuk besohet, nuk të duhet me patjetër të biesh dakord për procedurën që autoritetet duan të vijojnë duke imagjinuar një moshë tjetër tënden ndryshe nga ajo që ti ke treguar